



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 2

Tiranë – E hënë, 21 janar 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 430, datë 21.1.2019	Shpallje për 2 vende vakante për pozicionin përkthyes..... 3

**NJOFTIM****Nr. 430, datë 21.1.2019****KOMISIONI I PAVARUR I
KUALIFIKIMIT SHPALL 2 VENDE
VAKANTE PËR POZICIONIN
PËRKTHYES**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e përkthyesit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: II-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë, preferohet në gjuhë të huaja dega Anglisht ose Drejtësi;

b) të kenë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip;

c) të kenë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;

d) kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Kushte të përgjithshme:

- kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 188, datë 4.3.2015;

- ndaj tyre të mos ketë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

- kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: “Rruga e Kavajës”, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë; Zyra e Protokollit, nga e hëna në të premte ora 8:30-17:00 ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019